

AKT THEMELIMI
DHE STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"BDPZ SOLAR PARK FOTOVOLTAIK" SHPK

Ky Akt Themelimi dhe Statut bazohet ne:

- Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi;
- Ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare ", i ndryshuar;
- Ne ligjin 9723 date 03.05.2007, " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ", i ndryshuar;

Kreu I

Themelimit, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Ortaket.

- 1.1. Sot me date 28.12.2023, ne themeluesit kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin BDPZ SOLAR PARK FOTOVOLTAIK shpk, veprimtaria e se ciles do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Akti te Themelimit.
- 1.2. Themeluesit e shoqerise jane :
 - Z. Renaldo Zaimaj, i datelindjes 16.06.1985, lindur ne Frasher Permet, shtetas Shqipetar i identifikuar me karte identiteti nr. 032515338 dhe nr. Personal I50616184G.
 - Z. Rako Paja, i datelindjes 04.07.1982, lindur ne Skrapar, Shtetas Shqipetar i identifikuar me karte identiteti me nr. 036958928 dhe nr. Personal I20704004O.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjisacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga legjisacioni shqiptar.

Neni 2

Objekti

- 1.1 Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne:

Ndërtimin e centraleve prodhuese për prodhimin e energjisë së rinovueshme fotovoltaike. Projekte elektromekanike dhe gjeotermale. Kursime të energjisë në ndërtesat industriale të kompanive private dhe shtetërore. Përfaqesimin e shoqërive të ndryshme, shqiptare apo të huaja, që kanë objekt të njëjtë apo të përafërt me atë të kësaj shoqërie. Në çfarëdo lloj forme projektimin, ndërtimin, instalimin dhe tregtimin e sistemeve të energjisë së rinovueshme,

parqeve diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për të tjérët, marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme, ndërtimi dhe aktivitete të tregtimit në të gjitha format e materialeve të ndërtimit. Dhënia e mbështetjes së plotë për operatorët me shoqerinë për prodhimet e shitura dhe objektet e përfshira. Mbështetje që perfshin mirëmbajtjen dhe riparimin e produkteve dhe instalimeve. Ndërmjetësim me komision për blerjen, shitjen, prodhimin, instalimin e sistemeve të burimeve të energjisë së rinovueshme, parqeve diellore, turbinave me erë dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për të tjérët, marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme. Shërbimet e komisionit financiar të ndërmjetësimit për blerjen, shitjen, prodhimin instalimin e sistemeve të ripërtëritshme të energjisë, formave diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për llogari të palëve të treta, marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme. Marketingun, prodhimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha llojeve të makinerive elektromekanike, ajër të kondicionuar, makineri termohidraulike, prodhimin dhe tregtimin e materialeve të ndërtimit si dhe ndërtimin e marketingun e makinerive të teknologjisë së lartë, elektrike dhe pajisjet elektronike. Kryerja e studimeve për ngrohje, gaz, pajisje hidraulike dhe instalimet elektrike. Më konkretisht, me tregues, por jo përfundimtar të renditjes, qëllimi i shoqërisë përfshin: Prodhami i kaldajave të çelikut, radiatorëve, të tubave plastik, depozitave plastike, kazan elektrik, panele alumini diellore spirale dhe pjesëve të tjera të ngjashme dhe marketingun e tyre. Importi, eksporti dhe tregtia e produkteve të ngrohjes, kondicionera, panele diellore të ujit, sistemet e gazit, sisteme të ventilimit, ndërtimin e pajisjeve hidraulike dhe të gjitha produkteve të produhuara prej çeliku. Instalimin dhe mirëmbajtjen e mallrave dhe produkteve të shoqërisë përmes serviseve teknike.

Neni 3

Kohezgjatja

3.1. Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete per nje afat kohe te pacaktuar;

3.2 Shoqeria mund te prishet ne çdo moment e mund te vendoset prej ortakeve.

Neni 4

Selia

4.1. Selia e Shoqerise është ne adresen : Durres, Lagija nr.17, Rruga Stef Kaçulini, Hyrja 2, Ambjenti N3, Zona Kadastrale 8515, Nr. Pasurie 5/2650+2- n3.

4.2. Transferimi i selise se Shoqerise ne një vend tjeter behet me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

4.3. Asambleja mund te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne

qytete te tjera te Shqiperise si edhe jashte saj.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 1'000'000 lek. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1. Ortaku themelues Renaldo Zaimaj: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme 500'000 lek, qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

3. Ortaku themelues Rako Paja: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme 500'000 lek, qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakut te vetem, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi e prek ortakun ne te njeften mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e 'shoqerise'
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;

- q) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj .

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per shoquerine per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar ;
- d) percaktimin e shperblimin per personat e permendur ne shkronjat " c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, pdrfshire perqatitjen e pasqyrate financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrate financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;

h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese:

i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqeshet ne Asamblene e Pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asamblejae Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbate vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambjelja e pergjitheshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjitheshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votive, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo me mjete elektronike, sipas parashkimeve te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".


Nese Asambleja e pergjitheshme nuk mund te mblidhet per shkak te kuorumi te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri so me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e Ortakeve vendos, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shpemdadene fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e Ortakeve vendos per ceshtje si:



- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkakrimin e likujdusve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- g) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikqyrjen e zbatimit te plotikave tregatere nga administratoret, perfshire perqatjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perlaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorve;
- f) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Biznesit per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Administrimi

- a) Asambleja e Ortakeve emeron nje ose me shume persona fizike si administntor te shoqerise. Afati i ematimit, eshte 5 vite, me te drejte ripteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombdtare te Biznesit.
- v) Admirdstratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligi, nuk mund te emerohen si admiratratre te nje shoqdie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
- c) Personat e meposhtem caktoher si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergithshme.

Te dhenat e identifikimit:



- Rako Paja, I datelindjes 04.07.1982, lindur ne Skrapar, Shtetas Shqipetar I identifikuar me karte identiteti me nr. 036958928 dhe nr. Personal I20704004O, me banim ne Durres, Rrashbull.

Neni 13

Kompetencat e Administratoreve

Administratori ka kompetenca, mban pergjegjesi dhe ka per detyre:

- a) te zbatoje politikat tregtare te Shoqërisë;



- b) te pregatise me shkrim dhe te dokumentoje kérkesat e Asamblesë së Ortakeve, marrjen e masave që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë;
- c) të thërrasë mbledhjen e Asamblesë sa herë vlerësohet e nevojshme, për interesa operative apo afatgjata te Shoqërisë apo masa të tjera të nevojshme e të përshtatshme;
- d) të kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standartet e kontabilitetit;
- e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e Shoqërisë;
- f) të sigurojë që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen për t'iu paraqitur Asamblesë së Ortakeve, së bashku me një raport të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit finanziar;
- g) të sigurojë që auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga eksperte kontabël të autorizuar, rapporti i auditimit t'u vihet në dispozicion Asamblesë se Ortakeve;
- h) ti propozojë Asamblesë së Ortakeve organigramen, personelin e punesar dhe shperblimet si dhe cdo kontrate per pune me kohe te pjeshme apo sherbime qe kerkon Shoqeria;
- i) shpërblimi i Administratorit eshte kompetence e Asamblese se Ortakëve;
- j) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në Statut;
- k) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- l) të kryejnë regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera.

Kreu IV

Pasqyrat Financiare dhe Viti finanziar

Neni 14

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me I Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Pejashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me date 31 Dhjetor.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, dokumentacionin vjetor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille te kerkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe ate per konhollet periodike te ushtruara, te cilat eshte I detyruar qe t'ia paraqese e dorezoj ne kohe ortakeve per t'i shqytuar e miratuar mbi bazene te drejes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja -riorganizimi i shoqerise

Neni 16

Prishja dhe likuidimi

Shpemdarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohzgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblse se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- 9) nese nuk ka kryer vepdmtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me pikat 3 te nenit 43 id ligjt 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likujdatore dhe shernuar ne cdo dokument te nxjere prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese" Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e proceduave te likuidimit ne gjendjen e aflesise paguese, me perjashtimte rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese ortaket nuk menin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brcnda 30 diteve pas prishjes, cdo personi interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 17

Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet bashkohest ipas Vendimit e Mbledhjes se Pergjitheshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuarma Ligjin nr. 9901 date 14.04.2012" Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare."

Neni 18

Baza Ligiore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin ne perputhje me kete Statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqipetar.

Per sa nuk parashikohet ne kele statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 19

Mosmarreveshjet


Per mosmarrecveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Giykata Shqiptare.

ORTAKET

E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"BDPZ SOLAR PARK FOTOVOLTAIK" SHPK

Z. RENALDO ZAIMAJ



Z. RAKO PAJA

